



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:014428  
Datë: 06.12.2022  
Numri i dokumentit: 03718024

C.nr.182/20

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil**, me gjyqtarin Shyqri Hoxha, me bashkëpunëtoren profesionale K.R. në çështjen juridike kontestuese të inicuar me padi nga ana e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, kundër të paditurit N.B. nga fshati .... Komuna e Prizrenit, me objekt kontesti rimbursim i dëmit material dhe jomaterial, me vlerë të kontestit prej 1,302.00 euro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 06 dhjetor .2022, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
**(Për shkak të mosbindjes)**

- I. **APROVOHET** në tërësi si e bazuar kërkesëpadija e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë.
- II. **DETYROHET** i padituri, N.B. nga fshati .... Komuna e Prizrenit, që paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit, në emër të rimbursimit të dëmit material dhe jomaterial të ia kompensoj shumën e përgjithshme prej 1,302.00 (një mijë e treqind e dy) euro, me kamatë sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 31.01.2020, deri në pagimin definitiv, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.
- III. **DETYROHET** i padituri që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej **186,00 (një qind e tetë euro e zero cent)** euro, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

**A r s y e t i m**

Paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi me datë 31.01.2020, me kërkesë për rimbursimin e dëmit material dhe jo material të

shkaktuar nga aksidenti i datës 06.07.2018, kundër të paditurit N.B. nga fshati ....Komuna e Prizrenit.

Në padi, përfaqësuesi i paditëses ka theksuar se i padituri me datë 06.07.2018 në Prizren, me automjetin të cilin e drejtonte ka shkaktuar aksident nga pakujdesia, duke i shkaktuar dëme të dëmtuarve R.K. dhe F.A. Meqenëse në momentin e shkaktimit të aksidentit automjeti që ka qenë shkaktar i aksidentit ka qenë me afat të skaduar të policës së sigurimit, paditësja në bazë të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia si dhe në pajtim me dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, të dëmtuarve iu ka kompensuar dëmin material dhe jo material, kështu duke pasur parasysh faktin se me të paditurin nuk kan arritur pajtim jashtëgjyqësor, ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia dhe të obligohet e paditura në përmbushjen e detyrimit, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Gjykata, në bazë të nenit 150 të Ligjit për Procedurën Kontestimore me datë 12.03.2022 ka marrë aktvendimin C.nr.182/2020, me të cilin ka detyruar të paditurin që mbrenda afatit ligjor të paraqes përgjigje në padi dhe e ka njoftuar të paditurën për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, gjegjësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes - pa dëgjueshmërisë.

Në bazë të shkresave të lëndës, i padituri me datë 09.06.2020 në mënyrë të rregullt ka pranuar aktvendimin C.nr.182/2020 të datës 12.03.2022 së bashku me padinë dhe provat e bashkëngjitura në padi (provë fletëkthesa në shkresat e lëndës), por që brenda afatit ligjor nuk ka parashtruar përgjigje në padi pranë kësaj gjykate.

Gjykata, pas analizimit të shkresave të lëndës, në bazë të nenit 150 të LPK-së ka vlerësuar se në rastin konkret janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të padëgjueshmërisë (mosbindjes), pasi që në nenin 150 par.1 të LPK-së thuhet se: *"Në qoftë se i padituri, brenda afatit të përcaktuar me këtë ligj, nuk e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi, gjykata jep aktgjykim me të cilin e aprovon kërkesëpadinë (aktgjykimi për shkak të mosbindjes) po që se janë plotësuar këto kushte: a) po që se të paditurit i është dorëzuar rregullisht padia dhe thirrja për dhënien e përgjegjës në padi; b) po që se themelësia e kërkesëpadiisë del nga faktet e treguara në padi; c) po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia nuk janë në kundërshtim me provat që i ka propozuar vet paditësi apo me faktet e ditura botërisht."*

Themelësia e kërkesëpadiisë del nga provat të cilat gjenden ne shkresat e lëndës dhe atë nga: raporti i aksidentit me numër 2018 - GR - 0501 i datës 06.07.2018, kallëzimi penal nr.2018- GR- 0501 i paraqitur nga Policia e Kosovës - Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor në Prizren, kundër të paditurit Neljim Bajra, ujdia jashtëgjyqësore e datës

04.10.18 e lidhur mes paditëses dhe të dëmtuarit R.K. ujdia jashtëgjyqësore e datës 12.10.18 e lidhur mes paditëses dhe F.A. transferet bankare të datës 12.10.2018 dhe 24.10.2018 si dhe nga konfirmimi i polisës siguruese.

Gjykata pas analizimit të provave të paraqitura nga paditësja, respektivisht nga raporti i aksidentit me numër 2018 – GR – 0501 i datës 06.07.2018 vërtetohet se i padituri ka shkaktuar aksidentin e komunikacionit me dëme materiale dhe jo materiale, faktin e lartcekur e verteton edhe kallëzimi penal nr.2018- GR- 0501 i paraqitur nga Policia e Kosovës – Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor në Prizren, kundër të paditurit N.B. Nga ujdia jashtëgjyqësore të datës 04.10.18 të lidhur mes paditëses dhe R.K. vërtetohet fakti se paditësja ia ka paguar të dëmtuarit në emër të zhdëmtimit shumë prej 437,00 euro, e që ky fakt vërtetohet edhe përmes transferit bankar të datës 12.10.2018. Gjithashtu nga ujdia jashtëgjyqësore të datës 12.10.18 të lidhur mes paditëses dhe F.A. vërtetohet fakti se paditësja iu ka paguar të dëmtuarve në emër të dëmit material dhe jomaterial shumë prej 865,00 euro, vertetuar kjo edhe nga transferi bankar i datës 24.10.2018.

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit lidhur me lartësinë e rimbursimit të dëmit material dhe jomaterial vendosi duke u bazuar në ujdite jashtëgjyqësore dhe në transferet bankare nga të cilat vërtetohet se shuma e përgjithshme e pagesës së dëmit material dhe jo material është gjithsej 1,302.00 euro, si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me nenin 136 par.1 të LMD-së, është paraparë se: *“baza e përgjegjësisë i bie atij që e shkaktonte dëmin dhe i cili ka për detyrë ta kompensoi dëmin në qoftë se nuk provohet se dëmi ka lindur pa fajin e tij”*, që në rastin konkret dëmi ka lindur me fajin e të paditurit, ndërsa në nenin 169 par.1 të LMD parashihet se: *“Personi përgjegjës ka për detyrë ta rimborsosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi”*, pasi që Byroja Kosovare e Sigurimit (këtu paditësja) në bazë të nenit 18 par.1 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia iu ka paguar dëmin material dhe jo material të dëmtuarve, i padituri obligohet të ia paguaj paditësit shumë përkatëse në të holla në emër të rimbursimit të dëmit si në dispozitiv të aktgjykimit, në bazë të dispozitave të lartcekura.

Gjykata vendosi që pala e paditur të paguan kamatën sipas mjeteve të deponuara në bankat afariste mbi një vit pa destinim të caktuar nga data e ushtrimit të padisë në gjykatë (06.12.2019), në bazë të nenin 2 pika pika 2.1 të LPK-së.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e mori në bazë të nenit 449, 452 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet 156 euro për përpilimin e padisë dhe 30 euro në emër të taksës gjyqësore.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 150 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr.182/2020, datë 06 dhjetor 2022**

**Bashkëpunëtore profesionale**  
**Kadire Rexha**

**Gj y q t a r i**  
**Shyqri Hoxha**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.